



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.388/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi Kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 07.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN TE PABAZUARA ankesat Anr.388/2025 dhe Anr.389/2025 të datës 05.02.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat A.nr.388/2025 dhe Anr.389/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (LDK),

Në ankesën Anr.388/2025 pretendohet se Më 5 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputet të PDKsë, Fadil Demakuj, në fshatin Runik, të Skenderajit. Ky banes/ poster është vendosur në hapësirë publike pa leje të organeve kompetente. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur :Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kunërshtim me LZP.

Në ankesën Anr.389/2025 pretendohet Më 5 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në

hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputet të PDKsë, Shahin Dervishaj, në fshatin Runik, të Skenderajit. Ky banes/poster është vendosur në rrugë publike pa leje të organeve kompetente. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur :Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik PDK kanë bërë Shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.21 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Në përgjigjen e ankesës Anr.388/2025 thekson se e kundërshton ankesën e subjektit politik LVV dhe thekson se në ankesë është pretenduar se posterët e kandidatit për deputet z. Fadil Demaku, janë vendosur në muret e shtëpisë private, ku pronar është z. Murat Dauti, e që në fakt ky pretendim është i paqëndrueshëm, pasi që siç mund të vërehet edhe në provat e bashkëngjitura në këtë ankesë, posteri është i vendosur në murin e shtëpisë private të z. Murat Dauti. Megjithatë, për faktin se posterët janë të vendosur në shtëpinë private, në parcelën numër 597, përkatësisht në hapësirën që shihet në provën e bashkëngjitur në ankesë, PDK njofton se kjo shtëpi është në pronësi të z. Murat Dauti, andaj hapësira në të cilën është vendosur baneri/posteri nuk përbëjnë hapësirë publike, pasi që posterët janë të vendosur në pikërisht në shtëpinë private të z. Murat Dauti.

PDK e konsideron të rëndësishme që të sqaroj faktin se shtëpia e cila është objekt i kësaj ankese është shtëpi e cila përbën simbol të rezistencës shqiptare, në të cilën është mbajtur Referendumi për Pavarësi në vitin 1990 dhe gjithashtu në këtë shtëpi ka qenë e vendosur zyra e Heroit të Kombit Hamëz Jashari, në kohën kur është formuar Partia Republikane. Gjithashtu vlenë të theksojmë se kjo shtëpi ka qenë cak i atakimeve dhe sulmeve të vazhdueshme nga forcat paramilitare serbe dhe se kjo shtëpi është djegur nga pikërisht forcat paramilitare serbe, duke rezultuar në zhdukjen e fletave poseduese dhe certikatave të pronësisë për këtë ngastër kadastrale, andaj në mungesë të tyre është e pamundur që të bashkagjiten këto dokumente përkatëse, mirëpo konsiderojmë se është e pakontestueshme që prona e Cila është Objekt i kësaj ankese, nuk është hapësirë publike, mirëpo pronë private.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkangjitur : Pëlqimi me shkrim i z. Murat Dauti, për dhënien në shfrytëzim të parcelës për vendosjen e banerëve për reklamim në fushatën zgjedhore, e datës 29 janar 2025.

Në përgjigjen e ankesës Anr.389/2025 theksohet se pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshme për arsye se për vendosjen e posterit të kandidatit z. Shahin Dervishaj siç mund të vërehet nga provat e bashkëngjitura posteri është i vendosur në parcelën private të objektit afarist në pronësi të z. Faruk Dragaj. Andaj i njëjti përmes aktit të shkruar të pëlqimit të datës 20 janar 2025 i ka dhënë pëlqimin z. Shahin Dragaj për vendosjen e posterit në këtë hapësirë private.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkangjitur :Certifikatën e regjistrimit në ARBK, e biznesit me emrin Dema Runik SH.P.K, si dhe Pëlqimin me shkrim i z. Faruk Dragaj për dhënien në shfrytëzim të parcelës për vendosjen e banerve për reklamim në fushatë zgjedhore, e datës 20 janar 2025.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.388/2025, A.nr.389/2025, të paraqitura me datë 05.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.388/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik Partia Demokratike e Kosovës, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj, dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Ankesat janë të pa bazuara.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Pëlqimi me shkrim i z. Murat Dauti, për dhënien në shfrytëzim të parcelës për vendosjen e banerëve për reklamim në fushatën zgjedhore, e datës 29 janar 2025, Certifikatën e regjistrimit në ARBK, e biznesit me emrin Dema Runik SH.P.K, si dhe Pëlqimin me shkrim i z.Faruk Dragaj për dhenien në shfrytëzim të parcelës për vendosjen e banerve për reklamim në fushatë zgjedhore, e datës 20 janar 2025 erdhi në përfundim se subjekti politik PDK ka pasur pëlqim për vendosjen e posterave në parcelat private.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nëni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.388/2025 më datën 07.02.2025

**Kryesuesi i Panelit,
Arsim Hamzaj**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.